

Në bazë të nenit 39 të Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 82/2008, 12/2009, 53/2011, 150/2015 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 190/2019, 122/21), Qyteti i Shkupit shpall:

**Thirrje publike  
për angazhimin e anëtarëve në  
Komisionin për Avancimin e të Drejtave të Pacientëve**

**Qëllimi i Thirrjes publike:**

Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve Qyteti i Shkupit formon Komisionin e përhershëm për avancimin e të drejtave të pacientëve, në përputhje me dispozitat ligjore nga fusha e qeverisjes vendore.

Komisioni përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë, si vijon: dy përfaqësues të pacientëve – anëtarë të shoqatave së pacientëve, dy përfaqësues të organizatave joqeveritare që merren me të drejtat e njeriut dhe iniciativat civile, një përfaqësues nga shoqatat të cilat merren me të drejtat e grave, një përfaqësues nga shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, dy mjekë nga komunat dhe tre anëtarë të deleguar të Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Anëtarët e Komisionit për avancimin e të drejtave të pacientëve nuk duhet të jenë të punësuar në institucionet shëndetësore në të cilat jepet mbrojtja shëndetësore.

Mandati i anëtarëve të komisionit është dy vjet, me të drejtë edhe të një zgjedhjeje të njëpasnjëshme.

Qyteti i Shkupit siguron mbështetje logjistike dhe mjete për punën e anëtarëve të komisionit.

Formimi i Komisionit për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve dhe përbërja e tij do të propozohen në seancën e Këshillit të Qytetit të Shkupit.

**Në Thirrjen publike mund të aplikojnë:**

1. Organizata civile të pacientëve, organizata të cilat merren me të drejtat e njeriut dhe iniciativat civile, organizata të cilat merren me të drejtat e grave dhe organizata për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara, të cilët duhet të emërojnë nga një përfaqësues të tyre për anëtar të komisionit.
2. Individë, mjekë ose profesione të tjera.

**Detyrat e punës së anëtarëve të komisionit:**

- Pjesëmarrje e rregullt dhe aktive në takimet e komisionit;
- Përgatitja dhe realizimi i Planit të punës të komisionit me kornizë kohore;
- Përgatitja e Rregullores për punë të komisionit si dhe akteve të tjera;
- Ndjekja dhe vlerësimi i gjendjes me mbrojtjen e të drejtave të pacientëve;
- Shqyrtimi i ankesave të pacientëve dhe propozimi i masave për përmirësimin e të drejtave të pacientëve pranë organeve kompetente;
- Përgatitja dhe prezantimi i raportit për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, para Këshillit të Qytetit të Shkupit,

- Përgatitja e informacioneve, materialeve promotive me qëllim avancimin e të drejtave të pacientëve;
- Realizimi i aktiviteteve të tjera për avancimin e të drejtave të pacientëve dhe mbrojtjen e tyre;

#### **Kritere të cilat duhet t'i plotësojnë kandidatët/et:**

- Të kenë të përfunduar arsimin sipëror (si përparësi do të konsiderohet përfundimi i studimeve në degën e mjekësisë, drejtësisë, punës sociale, por nuk përjashtohen edhe studime të tjera);
- Përvojë pune në fushën përkatëse ose në punë adekuate/ sektori i veprimit: shëndetësi ose sektori juridik, shoqëri civile, demokratizim, të drejtat e njeriut, diversitet kulturor dhe dialog, shëndetësi, punë sociale-humanitare, nacionalitete, përfaqësimi dhe lobimi i pacientëve si dhe i personave tjerë të marginalizuar;
- Pjesëmarrja në projekte që çojnë në:
  - avancimin e shëndetit dhe të drejtave të pacientëve;
  - promovimin e mundësive të barabarta dhe avancimin e të drejtave të njeriut;
  - zvogëlimin e stigmatizimit dhe diskriminimit të pacientëve;

#### **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim**

1. Organizatat joqeveritare të interesuara, duhet të depozitojnë dokumentet e mëposhtme:
  - Formular me informacionet për organizatën;
  - Letër nominimi nga organizata për emërimin e një personi për anëtar të komisionit;
  - CV (Biografi profesionale) e personit të nominuar dhe fotokopje nga diploma për arsimin e përfunduar;
  - Dokumentacion tjetër me të cilin organizata joqeveritare konsideron se mbështet aplikimin dhe është në funksion të kriterëve të theksuara për zgjedhjen e anëtarit të komisionit.
2. Individët e interesuar duhet të depozitojnë dokumentet e mëposhtme:
  - CV (Biografi profesionale) dhe fotokopje nga diploma për arsimin e përfunduar;
  - Letër për motivim;
  - Dokumentacion tjetër me të cilin kandidati/ja konsideron se mbështet aplikimin dhe është në funksion të kriterëve të theksuara për zgjedhjen e anëtarit të komisionit.

Vlerësimi i propozimeve të arritura do të kryhet nga Komisioni për verifikim dhe çështje mandati, për mirënjohje, parashtrësia dhe ankesa, duke depozituar propozimin pranë Këshillit të Qytetit të Shkupit.

#### **Afati dhe mënyra e depozitimit të aplikimeve**

Afati përfundimtar i depozitimit të aplikimeve është deri më 13.05.2022, deri në orën 16:00.

Aplikimi së bashku me të gjithë dokumentacionin e skanuar depozitohen nëpërmjet postës elektronike, në adresën: [pravanapacienti@skopje.gov.mk](mailto:pravanapacienti@skopje.gov.mk) (me shënim në lëndën – Aplikim për Shpallje publike).

#### *Për informacione shtesë:*

Pyejte për sqarime plotësuese mund të parashtrihen nëpërmjet mënyrës elektronike në [pravanapacienti@skopje.gov.mk](mailto:pravanapacienti@skopje.gov.mk) dhe në numrin e telefonit tel: 02/ 3297 278. Personi për kontakt Igor Stevçeski, bashkëpunëtor në Seksionin për Mbrojtjen Sociale, të Fëmijëve dhe Shëndetësore, Sektori për Veprimtari Publike, Qyteti i Shkupit.